



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-86625, dt. 29 Tetor2024

Në bazë të nenit 11, 12 dhe nenit 17 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 dhe nenit 4 paragrafi 2. nënpika 2.4.3.5 të Ligji Nr. 03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin shpalljes së interesit publik të ngastrës kadasrale P-71611077-00203-3 ZK Ramun të bashkëpronarëve Leutrim (Florim) Kelmendi dhe Ramë (Bajram) Muzlija, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 tetor 2024, merr këtë:

VENDIM

Nr. 62/2024

Për Shpalljen e Interesit Publik për ngastrën kadasrale P-71611077-00203-3 ZK Ramun, për krijimin e hapësirës për varreza në fsh. Ramun

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës që të **SHPALLET** interesi publik ngastra kadasrale P-71611077-00203-3 ZK Ramun, me sipërfaqe 5039m² e bashkëpronarëve Leutrim (Florim) Kelmendi dhe Ramë (Bajram) Muzlija, me qëllim të krijimit të hapsirës për varreza në Fshatin Ramun, ZK Pejë.
- II. Për tu realizuar një projekt i tillë, prek interesat e pronës private të bashkëpronarëve Leutrim (Florim) Kelmendi dhe Ramë (Bajram) Muzlija, të identifikuar në qerifikatën e pronës, prek ngastrën kadastrale 203/3 ZK Ramun.
- III. Shpallja e interesit publik bëhet me qëllim që paluajtshmëria e përshkruar në pikën I të këtij Vendimi, të kaloj në pronësi të Komunës, pas një procedure të shpronësimit apo këmbimit, për realizimin e qëllimit publik për krijimin e hapsirës për varreza në Fshatin Ramun.
- IV. Prona e shpallur si interes publik në pikën I të këtij Vendimi do të shërbej ekskluzivisht për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik.
- V. Në bazë të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës do të inicioj procedurat e mëtutjeshme për shpronësimin apo këmbimin e pronës në fjalë për interes publik konform dispozitave ligjore në fuqi.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për çështje Pronsoro-Juridike.

VII. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

